

RREGULLORE

E

MBLEDHJES SË POSAÇME TË GJYQTARËVE TË GJYKATËS SË LARTË

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për mënyrën e funksionimit të Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (në vijim *Mbledhja e Posaçme*), si dhe për procedurën që ndiqet për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Baza ligjore

Miratimi i kësaj rregulloreje bazohet në nenin 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*” (i ndryshuar).

KREU II

THIRRJA E MBLEDHJES SË POSAÇME DHE PROCEDURA

Neni 3

Njohja e gjyqtarëve me raportin dhe listën e kandidatëve të paraqitur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së raportit të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Kryetari i Gjykatës së Lartë ua bën të njohur gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, listën, së bashku me dokumentacionin shoqërues për secilin kandidat.

Neni 4

Thirrja e Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë

Jo me vonë se 10 ditë nga dërgimi i raportit dhe listës së kandidatëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës së Lartë njofton për ditën e zhvillimit të Mbledhjes së Posaçme për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 5

Pjesëmarrja në Mbledhjen e Posaçme

Në Mbledhjen e Posaçme marrin pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të gjyqtarit, kandidat për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 6
Kuorumi i Mbledhjes së Posaçme

1. Mbledhja e Posaçme është e vlefshme nëse marrin pjesë jo më pak se tre të katërtat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë merr pjesë personalisht dhe nuk mund të përfaqësohet nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës.
3. Në rast se Mbledhja e Posaçme dështon për shkak të mosplotësimit të kuorumit, Kryetari i Gjykatës së Lartë shtyn mbledhjen dhe cakton një datë tjetër për zhvillimin e saj.

Neni 7
Drejtimi i Mbledhjes së Posaçme

1. Mbledhja e Posaçme drejtohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe, në pamundësi, nga Zëvendëskryetari i Gjykatës.
2. Kancelari i Gjykatës së Lartë merr masat e nevojshme për organizimin e Mbledhjes së Posaçme dhe funksionimin e sekretarisë teknike të mbledhjes.
3. Kryetari i Gjykatës së Lartë si drejtues i punimeve të Mbledhjes së Posaçme, merr masa për zhvillimin normal të saj deri në daljen e rezultatit përfundimtar.
4. Procedura e zhvillimit të Mbledhjes së Posaçme pasqyrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe sekretarja e ngarkuar për hartimin e tij.

Neni 8
Deklarimi i konfliktit të interesit

1. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë, i cili, për shkak të lidhjeve me njërin nga kandidatët e përzgjedhur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vlerëson se është në kushtet e konfliktit të interesit, i paraqet kërkesë Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili vendos për miratimin ose refuzimin e saj. Edhe në rastet e paraqitjes së kërkesës për përjashtim vendoset sipas të njëjtës procedurë.
2. Nëse pranohet kërkesa për heqjen dorë ose për përjashtim, gjyqtari nuk merr pjesë në Mbledhjen e Posaçme dhe në votimin e kandidatit për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese. Për shqyrtimin e kërkesës për heqjen dorë të Kryetarit të Gjykatës së Lartë vendos Mbledhja e Posaçme.
3. Qenia e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk përfshihet në rrethin e shkaqeve që përbëjnë konflikt interesi, sipas ligjit.

KREU III
ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË VOTIMIT

Neni 9
Komisioni i votimit

Për zhvillimin e procedurës së votimit dhe shpalljen e rezultatit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese nga Mbledhja e Posaçme, krijohet komisioni i votimit, i përbërë nga Kancelari i Gjykatës së Lartë, Kryesekretari dhe një sekretare gjyqësore.

Neni 10
Shpjegimi i rregullave të votimit

Përpara fillimit të votimit, komisioni i votimit shpjegon mënyrën dhe rregullat e votimit.

Neni 11

Përmbajtja e fletës së votimit

1. Votimi bëhet duke përdorur fletën e votimit të miratuar paraprakisht nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.
2. Fleta e votimit përmban elementet e mëposhtëm:
 - a) Emrin dhe mbiemrin e plotë të tre kandidatëve;
 - b) Vendin e posaçëm për votim;
 - c) Një shënim në fund të fletës së votimit ku renditen shkaqet ligjore të pavlefshmërisë së votës.
3. Kandidatët renditen në fletën e votimit sipas listës së paraqitur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Neni 12

Procesi i votimit

1. Votimi për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese nga Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është i fshehtë dhe individual.
2. Procesi i votimit është i mbyllur, rezultati i votimit bëhet publik menjëherë.
3. Pas shpjegimit të rregullave të votimit, komisioni vijon me procedurën e votimit të kandidaturave për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.
4. Anëtarët e komisionit të votimit nënshkruajnë dhe vulosin të gjitha fletët e votimit, të cilat janë të barabarta me numrin e gjyqtarëve të pranishëm në Mbledhjen e Posaçme.
5. Komisioni i votimit i dorëzon çdo gjyqtari fletën përkatëse të votimit, i cili e plotëson atë në dhomën e fshehtë, e më pas e hedh në kutinë e votimit.
6. Çdo gjyqtar ka të drejtën e një vote dhe votimi me përfaqësim nuk lejohet. Abstenimi nuk lejohet.
7. Gjyqtarët ndjekin rregullat e votimit si vijon:
 - a) votohet vetëm në fletën e votimit të vënë në dispozicion nga komisioni i votimit;
 - b) votohet duke vendosur në kutinë përkatëse, përbri emrit të kandidatit të preferuar, njërën nga shenjat “+” ose “x” ose “v”.
6. Në fletën e votimit nuk duhet të bëhen shënime të tjera, përveç shenjës së votimit.

Neni 13

Pavlefshmëria e votës

Vota është e pavlefshme kur:

- a) fleta e votimit nuk ka të njëjtët elemente, sipas formatit të miratuar;
- b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;
- c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;
- ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;
- d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;
- dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit

Neni 14

Numërimi i votave

1. Pas përfundimit të votimit, komisioni i votimit hap kutinë në praninë e të gjithë gjyqtarëve të Mbledhjes së Posaçme, fillon numërimin e votave dhe vijon me nxjerrjen e rezultatit përfundimtar.
2. Procesi i numërimit të fletëve të votimit dhe i nxjerrjes së rezultatit të votimit është i hapur.
3. Çdo fletë votimi i tregohet gjyqtarëve të pranishëm në mbledhje.
4. Komisioni i votimit vlerëson fillimisht votat e vlefshme dhe pastaj fillon numërimin e tyre.
5. Votat që gjykohen paraprakisht si të pavlefshme rivlerësohen nga anëtarët e komisionit në fund të procesit të numërimit, dhe votat që pas rivlerësimit gjykohen të vlefshme u shtohen kandidatëve përkatës.

Neni 15

Shpallja e rezultatit të votimit

1. Komisioni i votimit, pas përfundimit të numërimit të votave, rendit kandidatët sipas votave që kanë marrë.
2. Në fund të procesit të votimit dhe të numërimit të votave hartohet një procesverbal, i cili tregon numrin e pjesëmarrësve, të votave të hedhura, numrin e votave të pavlefshme, në qoftë se ka të tilla, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve të përzgjedhur. Rastet e mosmarrëveshjeve për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.
3. Në përfundim të procesit të votimit konsiderohet i zgjedhur për vendin vakant të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, kandidati që ka marrë 3/5 e votave të gjyqtarëve votues.
4. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë 3/5 e votave, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konsiderohet i zgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 16

Njoftimi i vendimit

1. Vendimi i Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese i përcillet Kryetarit të Kuvendit, Presidentit të Republikës, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare për botim në Fletoren Zyrtare.
2. Kur nuk arrihet shumica prej 3/5 të votave dhe anëtari i Gjykatës Kushtetuese konsiderohet i zgjedhur *ex lege*, Kryetari i Gjykatës së Lartë i dërgon institucioneve të përmendura në pikën 1 të këtij neni njoftimin për rezultatin e votimit të Mbledhjes së Posaçme, së bashku me vendimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që bën renditjen e kandidatëve.

KREU

DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 17

Kuorumi i Mbledhjes së Posaçme

Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje, bazuar në nenin 86/5 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës së Kushtetuese është e vlefshme nëse marrin pjesë të paktën gjysma e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Neni 18

Miratimi i Rregullores

Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë miraton këtë rregullore të paktën 15 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 19 **Ndryshimet**

Ndryshimet në këtë rregullore miratohen me shumicën e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Propozimi për ndryshimet në rregullore bëhet nga Kryetari ose me kërkesën e çdo gjyqtari të Gjykatës së Lartë.

Neni 20 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Mbledhja e Posaçme dhe botohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.